



2016 Raport Vjetor

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Përmbledhje

HYRJE	4
Konsiderata të Përgjithshme	6
KAPITULLI I	8
VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI.....	8
I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor	8
II.2.Situata e diskriminimit në Shqipëri	13
KAPITULLI II.....	29
VEPRIMTARIA E KMD NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE.....	29
PROMOVIMIN E BARAZISË	29
II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit.....	29
II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	29
II.1.1.1.Çështje të trajtuara.....	29
II.1.1.2. Ankuesit	30
II.1.1.3. Çështje të nisura kryesisht.....	30
II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara	32
II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.....	33
II.1.1.7. Seanca dëgjimore dhe hetime administrative	34
II.1.1.8. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara	34
II.1.2. Asistenca ndaj viktimave në proceset gjyqësore.....	35
II.2. Rekomandime legjislative dhe opinione	36
II.2. 1.Rekomandime Legjislative.....	36
II.2.2.Opinione	37
II.3. Ndërgjegjësimi	38
II.4. Raportime, studime dhe monitorime	40
II. 5. Bashkëpunime	41
II.6. Projekte.....	43
KAPITULLI III.....	45

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE.....	45
III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore	45
III.2. Menaxhimi i burimeve financiare	46

**I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar Deputetë,**

Me përgjegjësinë që mbart Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe sjelljet që e nxisin atë, po paraqesim pranë Kuvendit të Shqipërisë Raportin Vjetor 2016.

Aktiviteti i Komisionerit është zhvilluar në funksion të ushtrim të detyrave të tij, mbi zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ky raport është konceptuar duke mbajtur parasysh detyrimin ligjor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të parashikuar në nenin 26 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku thuhet shprehimisht se “Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e Komisionerit dhe të zyrës”.

Përmbajtja e këtij raporti është ndërtuar bazuar në misionin dhe objektivat e Zyrës së Komisionerit, si dhe në rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë ka adresuar për vitin 2016.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU

HYRJE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit, vlerëson mbrojtjen efektive të së drejtës së çdo individi për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi, si një prioritet të aktivitetit të tij dhe si një çështje me rëndësi të veçantë të progresit të shtetit shqiptar drejt integritit në Bashkimin Europian.

Puna e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit me organizata të ndryshme jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë grupeve në nevojë, institucioneve të ndryshme në nivel qendror dhe vendor, medias dhe publikut.

Edhe gjatë vitit 2016, veprimtaria e KMD është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e institucionit të KMD për vitin 2015.

Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit për çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me “*Projekt - Rezolutën për Vlerësimin e Punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015 dhe rekomandimet për vitin 2016*”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit, për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që e nxit diskriminimin.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe masash për:

Së pari, ofrimin e një asistence të kualifikuar ndaj viktimave të diskriminimit përmes trajnimit të aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë:

- Trajnimin e vazhdueshëm të stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për trajtimin e çështjeve të diskriminimi.
- Trajnime të KMD-së në bashkëpunim me policinë;
- Trajnimin e OJF-ve mbi identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe rrugët që mund të ndjekin për të asistuar viktimat e sjelljes diskriminuese.
- Trajnime me Shkollën e Magjistraturës;

Së dyti, ndërgjegjësimin e shoqërisë në përgjithësi dhe grupeve specifike në veçanti përmes:

- Botimeve të ndryshme të KMD dhe botimeve të tjera;
- Përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informuese në gjithë territorin e Republikë së Shqipërisë
- Vazhdimin e fushatave ndërgjegjësuere në shkollat 9- vjeçare;
- Leksioneve të hapura me studentët.

Së treti, dhënien e rekomandimeve legislative. Komisioneri ka synuar në përafrimin e legjislacionit ekzistues në përputhje me parashikimet e Ligjit "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", kryesisht në lidhje me:

- shkaqet e diskriminimit për të cilat këto ligje ofrojnë mbrojtje;
- format e diskriminimit;

Konsiderata të Përgjithshme

- KMD i ka kushtuar një vëmendje të veçantë nxitjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke shfrytëzuar disa instrumente, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave. Kontributi i punonjësve të KMD në median e shkruar dhe elektronike, organizimi i workshop-eve, tryezave, seminareve dhe konferencave, organizimi i Ditëve të Hapura, forcimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, institucione të pushtetit qëndror dhe vendor, universitetet dhe aktorë të tjerë, i ka krijuar më shumë mundësi institucionit të KMD-së të ndërgjegjësojë publikun në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, përmes organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere është rritur niveli i informacionit të publikut mbi mjetet ligjore, rolin e KMD, gjykatës.
- I është kushtuar vëmendje shpërndarjes së botimeve të ndryshme, me qëllim rritjen e informacionit të komunitetit mbi situatat diskriminuese dhe mjetet që mund të përdoren për adresimin e tyre. Faqja zyrtare e institucionit është rikonceptuar me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm të institucionit me ta.
- Gjatë vitit 2016, është rritur numri i rasteve të diskriminimit të konstatuara me vendim nga KMD. Raca, gjendja ekonomike, aftësia e kufizuar, bindjet politike, gjendja shëndetësore, janë ndër shkaqet kryesore të ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në shumë raste ankuesit, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit, kanë pretenduar diskriminimin e shumëfishtë, për më shumë se një shkak diskriminimi.
- KMD vlerëson të rëndësishme dhe mirëpret rritjen e rolit të organizatave jofitimprurëse, që punojnë për të drejtat e grupeve vulnerabël si fëmijët, gratë, përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, pasi këto organizata përbejnë një burim informacioni për KMD. Pavarësisht mundësive që parashikohen në ligjin nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për paraqitjen e ankesave para KMD nga

organizata me interesa legjitime, që pretendojnë diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, numri i ankesave të paraqitura prej tyre vazhdon të jetë i ulët në raport me numri total të ankesave të paraqitura për shqyrtim pranë KMD.

- Vërejmë se, numri i ankesave me pretendim diskriminim, për shkak të gjinisë dhe orientimit seksual dhe identitetit gjinor, vazhdon të mbetet relativisht i ulët.
- Gjatë vitit 2016, vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave me pretendim diskriminimi për shkak të bindjeve politike, në fushën e punësimit.
- I është kushtuar vëmendje e veçantë zgjerimit të mbledhjes së të dhënave dhe informimit nga institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe subjektet private. Kështu, për hartimin e një pjese të këtij raporti, KMD i është drejtuar për informacion institucioneve dhe OJF-ve.
- Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave ligjorë, harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përafrimin me të drejtën ndërkombëtare në fushën e mosdiskriminimit, janë përgatitur dhe dërguar rekomandime legjislative.
- Përmes organizimit të aktiviteteve informuese, trajnuese, etj. me aktorë të ndryshëm janë promovuar praktikat më të mira të KMD-së në adresimin e diskriminimit për shkaqe të ndryshme.
- Gjatë vitit 2016, janë organizuar, 19 sesione trajnimi në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë trajnuar në total 471 punonjës të Drejtorive Vendore të Policisë.
- Gjatë vitit 2016, punonjësit e KMD-së kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për trajtimin e ankesave në lidhje me diskriminimin për shkaqe të ndryshme, zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit.
- Me qëllim forcimin e bashkëpunimit të KMD-së me institucione të tjera janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi si dhe janë zhvilluar shumë aktivitete të përbashkëta. Përfshirja si anëtar në rrjetin EQUINET ka ndihmuar KMD-në të njihet dhe të përdorë më mirë praktikat e institucioneve homologe europiane dhe të japë kontributin e saj në këtë rrjet.
- KMD ka kontribuar në hartimin e raporteve/raportimeve në kuadrin e organizmave ndërkombëtare dhe rajonale, apo procesin e integritetit europian.

KAPITULLI I

VËSHTRIM MBI SITUATËN E DISKRIMINIMIT NË SHQIPËRI

I.1. Zhvillimi i kuadrit ligjor

- **Ligji nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.**

Ndryshimet që i janë bërë Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2016, kanë sjellë gjithashtu zhvillime në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Kështu, me ligjin nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është sanksinuar se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje, ndër të tjera, me kërkesë të çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta. Ky parashikim kushtetues i jep mundësinë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, lidhur me çdo parashikim diskriminues dhe që shkel parimin e barazisë.

- **Ligji nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”**

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet e administratës shtetërore për personat që banojnë dhe/ose që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji zbatohet, për të gjitha shërbimet që ofrohen nga institucionet e administratës shtetërore, duke përfshirë edhe shërbimet që ofrohen nga institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj. Ndër të tjera, ligji përcakton se një nga parimet themelore të ofrimit dhe sigurimit të shërbimeve publike në territorin e Republikës së Shqipërisë nga institucionet shtetërore, sipas këtij ligji është *parimi i mosdiskriminimit*.

Ky ligj ka parashikuar gjithashtu, se, institucionet e administratës shtetërore ofrojnë për të gjithë personat fizikë dhe juridikë akses në shërbimet publike *në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese*. Në mënyrë të qartë ky ligj ka bërë referim tek ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke përcaktuar se: “*Në çdo rast duhet të respektohen kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.*”¹, si dhe “*Një trajtim i ndryshëm i personave në ofrimin e shërbimeve lejohet vetëm mbi bazën e dallimeve objektive dhe shkaqeve të justifikuara, sipas legjislacionit që rregullon fushën e mosdiskriminimit.*”

- **Ligji nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”²**

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret, që garantojnë të drejtën e themelimit dhe të drejtën e ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë. Ligji zbatohet për të gjitha shërbimet e ofruara në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të shërbimeve të listuara në nenin 2 të ligjit.

Ligji ka parashikuar se ushtrimi i veprimtarisë së shërbimit të mos kushtëzohet nga kriteret diskriminuese. Në çdo rast, nëse kufizohet, kufizimi duhet të vendoset vetëm për një arsye madhore, që lidhet me interesin publik. Nga ana tjetër, duhet që kufizimet të jenë të përshtatshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

Gjithashtu, ligji parashikon se edhe për përfituesin apo marrësin e shërbimit ndalohet vendosja e kriterëve diskriminuese lidhur me kushtet e përgjithshme të përfitimit të një shërbimi të caktuar dhe të bërë publikë nga ofruesi, lidhur me shtetësinë apo vendin e qëndrimit të përfituesit. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, janë të mundshme kur justifikohen nga kriteret objektive.

- **Ligji nr. 44/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.**

Ky ligj në përputhje edhe me standartet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPK), si dhe ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”, ka integruar konceptet e “Vlerësimit bio-psiko-social” dhe “Komisionit shumëdisiplinor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar”. Konkretisht, këto koncepte përkufizohen si më poshtë:

“Vlerësimi bio-psiko-social” është një proces vlerësimi i faktorëve të ndryshëm dhe të ndërvarur, të cilët dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Këta faktorë janë: struktura

¹ Neni 8, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

² Ky ligj është përafëruar pjesërisht me direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006, “Për shërbimet në tregun e brendshëm” Celex : 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 376, datë 27.12.2006, faqe 36-68.

trupore, funksionet trupore e psikologjike, si dhe faktorë personalë, shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë.

“Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar” është një ekip i përzgjedhur, me mjek dhe punonjës social/psikolog, të cilët janë të punësuar pranë drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për procesin e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga mjekët, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara dhe verifikimin e informacionit me institucione të tjera.

Ligji ka shtuar si përfitues të shërbimeve shoqërore azilkërkuesit e mitur, të pashoqëruar.

Ligji nr. 44/2016, ka përcaktuar se përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 48 muajve punësimi, duke i mabjtur në skemë personat edhe për 24 muaj të tjerë, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm ligjor i futur me ligjin nr. 47/2014, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, i cili parashikonte se “Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 24 muajsh punësimi”*”.

Gjithashtu, ligji nr. 44/2016 ka parashikuar të drejtën e ankimit edhe në gjykatë. Ligji përcakton se, aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”*

Aktet e mëposhtme nënligjore kanë dalë në zbatim të ndryshimeve që ka bërë ligji nr. 44/2016 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, i ndryshuar.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 431, datë 8.6.2016** *“Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfutimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”*
- **Udhëzim i Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, nr. 22, datë 7.10.2016** *“Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal”*.

- **Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 21, datë 07.10.2016 “Për miratimin e kritereve për vlerëzimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot”.**
- **Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”**

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Ligji përcakton, llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërkimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe, rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij.

Ligji parshikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera edhe parimin e mosdiskriminimit. Ligji përcakton se, ndalohej çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjithashtu, ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ligji përcakton se, shërbimet e kujdesit shoqëror përdoren jo vetëm nga shtetasit shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë, por edhe nga shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët, por me banim në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, gëzojnë të drejtën e kujdesit shoqëror njësoj si shtetasit shqiptarë, personat, të të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë

- **Ligj nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”**

Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punë, janë përballur me situata diskriminuese. Për këtë arsye, vlerësojmë se

rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

- **Ligj nr. 134/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.**

Ky ligj mund të kishte sjellë zhvillime pozitive në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi për shkak të gjinisë. Në vitin 2015, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar se neni 16 dhe 17 i ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” diskriminojnë në mënyrë të tërthortë gratë, për shkak të gjinisë dhe praktika që ndiqet nga zyrat e gjendjes civile në zbatim të këtyre dispozitave sjell pasoja diskriminuese për gratë, duke mos ofruar shërbimet e përcaktuara nga ligji në baza të barabarta me burrat.

Për këtë arsye, Komisioneri i ka dërguar rekomandim Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të rishikojë nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 10 129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, në lidhje me konceptin e “Kryefamiljarit” dhe të detyrave të parashikuara nga ligji për të garantuar që në procedurat e deklarimit të vendbanimit të merret pëlqimi i të dy bashkëshortëve.

Nga përmbajtja e ligjit nr. 134/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, nuk rezulton që rekomandimi i Komisionerit të ketë gjetur pasqyrim.

- **Udhëzim i Ministrisë së Mirqënies Sociale dhe Rinisë, nr. 14, datë 10.5.2016 “Për ofrimin e shërbimit të emergjencës në institucionet e përkujdesit shoqëror të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit publik që ofrojnë shërbime të përkujdesit rezidencial për fëmijët në nevojë”.**

Ky udhëzim parashikon ofrimin e shërbimit të emergjencës për një periudhë kohore prej 72 orësh për fëmijët e identifikuar që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme në institucionet e përkujdesit social rezidencial publik, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit.

Sipas udhëzimit, fëmijë që ka nevojë për mbrojtje të menjëhershme është fëmija, “i cili nëse lihet në rrethanat aktuale pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë apo të jetë pre e keqtrajtimit të konsideruara vepër penale, sipas legjislacionit në fuqi”. Fëmijë që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme dhe që i ofrohet shërbimi i emergjencës në institucion përfshin “fëmijën e gjendur vetëm, të pashoqëruar në situatë rruge, fëmijën e neglizhuar, që jeton në rrethana që vendosin në rrezik jetën dhe shëndetin e tij, fëmijën e abuzuar seksualisht nga personat në gjini apo kujdestari”.

II.2.Situata e diskriminimit në Shqipëri

Për të realizuar një analizë mbi situatën e diskriminimit në Shqipëri i jemi referuar të dhënave nga veprimtaria e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, raporteve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat monitorojnë zbatimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Gjate vitit 2016, nga veprimtaria e Komisionerit, është vënë re, një ndërgjegjësim më i madh i publikut të gjerë dhe grupeve vulnerabël lidhur me identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe mbi mjetet ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, gjë e cila reflektohet në numrin e vendimeve të diskriminimit dhe rasteve për diskriminim të paraqitura në gjykata. Grupe vulnerabël; si komunitetit rom, egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, gratë, komuniteti LGBTI, etj. përballen me forma të ndryshme të diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim përmirësimin e situatës diskriminuese në Shqipëri, ka dhënë mendim për: Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020 në Republikën e Shqipërisë; Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2016 – 2020 në Republikën e Shqipërisë; Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 - 2020 dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020.

Diskriminimi për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës.

Megjithëse Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar parashikojnë norma që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe Shqipëria, ka miratuar traktatet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve, respektimi i këtyre të drejtave kërkon një angazhim maksimal për t'i bërë të realizueshme.

Komuniteti rom është komuniteti më i cënuar në Shqipëri, që përballlet me varfëri të skajshme, marxhinalizim social-ekonomik dhe diskriminim të vazhdueshëm, në veçanti për të drejtën e arsimimit, mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor, punësimit dhe të strehimit të përshtatshëm. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të legjislacionit dhe politikave për minoritetet. Vlen të evidentohet fakti se janë miratuar dokumenta të rëndësishme, që përcaktojnë qartazi masa për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe veçanërisht integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian: Plani Kombëtar i Integritit European 2015-2020;- Udhërrëfyesi për 5 Prioritetet e Komisionit European, Strategjia mbi Përfshirjen Sociale, Strategjia për Zhvillim dhe Integrim, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016 - 2020, Ligji “Për kujdesin shoqëror”, Projektligji “Për strehimin social” Integrimi i çështjeve të komunitetit rom dhe egjiptian në disa politika zhvillimi krijojnë më shumë mundësi për fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi prej Shtatorit 2016, ka marrë pjesë në takimet që janë zhvilluar në Ministrinë e Punëve të Jashtme³, në kuadër të Grupit Ndërinstitucional të Punës⁴ të ngritur për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me përfaqësues të Ministrive, Kryeministrisë, Kuvendin si dhe përfaqësues të institucioneve të pavaruara. Miratimi i këtij projektligji synon të përmirësojë kuadrin ligjor për mbrojtjen e pakicave.

Romët dhe Egjiptianët vazhdojnë të përballen me kushtet e vështira dhe diskriminimin e shpeshtë, në veçanti, në aksesimin e arsimit, punësimit, strehimit, shëndetit dhe regjistrimit civil. Plani i veprimit për integrimin e romëve 2016- 2020 u miratua në dhjetor. Buxheti i shtetit do të financojë 55% të veprimeve, ndërsa pjesa tjetër do të sigurohet nga donatorët. Konferenca e tretë BE- Shqipëri për përfshirjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, e mbajtur në prill, doli në disa konkluzione operacionale, të cilat përcaktuan prioritetet kryesore për dy vitet e ardhshme.

Strehimi. Kushtet e jetesës mbeten të dobëta, ku një pjesë e romëve nuk kanë akses në furnizimin me ujë të rrjedhshëm në shtëpi. Është miratuar strategjia kombëtare për strehim 2016- 2025. Kjo strategji synon të përmirësojë kuadrin institucional, ligjor dhe rregullator për shtëpitë me të ardhura të pakta ose mesatare, përfshirë Romët. Martesa me fëmijë mbetet një praktikë shqetësuese, e cila përfshin rreth 2.9% të fëmijëve rome, të grupmoshës 15-18 vjeç. Regjistrimi civil është përmirësuar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme, në veçanti për të lehtësuar transferimin e regjistrimit mes bashkive dhe të fëmijëve të lindur jashtë vendit. Mungesa e regjistrimit shpesh pengon aksesin në mbështetjen sociale⁵.

Shumë romë dhe egjiptianë, si dhe të rinj që largohen nga përkujdesi social, nuk arrijnë të përmbushin prapësi të ardhurave të nevojshme për të përfituar banesat sociale. Shumë romë nuk ishin në gjendje t’i nënshtroheshin rregullave për shtëpitë e tyre, sipas ligjit të vitit 2014 për legalizimin e pronës, e cila lejoi prishjen e “ndërtimeve pa leje”. Në korrik 2015, shtëpitë e 70 familjeve, kryesisht rome, u shkatërruan në Selitë, Tiranë, gjatë një dëbimi të detyruar me qëllim ndërtimin e rrugëve.⁶ Pavarësisht hapave të ndërmarrë, gjendemi përballë pengesave të shumta në efektet e tërthorta që sjell zbatimi i legjislationit. Ndonëse legjislationi parashikon mundësi për gëzimin e të drejtave të romëve dhe egjiptianeve, kriteret në përfitime të caktuara janë neutrale, ato shpesh nuk mund të përmbushen nga pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian duke e përjashtuar këtë komunitet nga gëzimi efektiv i të drejtave.

³Ministria e Punëve të Jashtme është institucioni koordinues i procesit të hartimit të projektligjit dhe akteve nenligjore

⁴ Në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr.121, datë 27.7.2016 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës

⁵ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2016>

⁶ Marrë nga “Amnesty International Report 2015/ 2016”, paragrafi “E drejta e strehimit”, faqe 64.

Ministria e Zhvillimit Urban ka propozuar një strategji të re të strehimit për të përfshirë romët dhe egjiptianët, me qëllim promovimin dhe legalizimin e vendbanimeve informale, si dhe për të përmirësuar qasjen në shërbime.⁷

Romët dhe egjiptianët jetojnë në kushte të papërshtatshme banimi, në zona periferike dhe pa infrastrukturë. Mungojn, sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza, furnizimi me ujë të rrjedhshëm në banesa dhe jashtë saj.⁸ Gjithashtu, familjet rome dhe egjiptiane shpesh banojnë në banesa nën standard dhe vuajnë pasigurinë e qiramarrjes. Kjo ndodh për faktin se, këta persona, të cilët nuk kanë mundësi të përballojnë strehimin në kushtet e tregut, kanë të drejtën të përfitojnë nga strehimi social, por një pjesë e romëve dhe egjiptianëve, nuk mund të aplikojnë për këto banesa sociale, pasi duke bërë punë informale, nuk kanë të ardhurat e mjaftueshme dhe/ose burime të ardhurash të verifikueshme për t'u kualifikuar⁹.

Arsimi. Kushtet dhe jetesa në vende periferike, si dhe niveli i ulët ekonomik ndikojnë në pamundësinë e fëmijëve të këtij komuniteti për t'u arsimuar, të pajisjes me tekste dhe material të tjera shkollore. Niveli i varfërisë, niveli i ulët arsimor dhe konceptet e prindërve, çojnë në ndërprerjen e shkollës nga një numër i konsiderueshëm i fëmijëve dhe në punësimin e tyre. Kjo gjendje ekonomike çon në pamundësinë e pagesës së shpenzimeve të jetesës dhe është një nga pengesat kryesore, për të rinjtë rom dhe egjiptian, në ndjekjen e arsimit të lartë. Integrimi i komunitetit rom, kërkon ndryshimin e koncepteve për mënyrën e të jetuarit, e cila duke marrë parasysh traditën dhe jetesën e tyre në komunitet (martesat e vajzave në moshë të mitur, dhunës ndaj gruas në familje etj.), kërkon kohë. Rinia rome, e cila është shumë e ndjeshme ndaj paragjykimeve, duhet të integrohet me të rinjtë e tjerë, duke e konsideruar veten si pjesa më aktive dhe e ndryshueshme e familjes, e cila do të sjelle këto ndryshime në konceptin e jetesës.

Gruaja rome, në kushtet e sotme, është e shtypur dhe e diskriminuar në familje, në të shumtën e rasteve është shtëpiake dhe e pashkolluar. Duke parë rolin që luan nëna në edukimin e fëmijëve, është e domosdoshme që ajo të jetë e integruar në shoqëri, të jetë e arsimuar dhe të krijojë të ardhura për familjen e saj duke u punësuar. Për shkak të ndërgjegjësimit të komunitetit, shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, si dhe punës së bërë nga KMD, është minimizuar në maksimum segregimi i fëmijëve rom dhe egjiptian në klasa të veçanta.

Sipas një studimi të Komitetit Shqiptar të Helsinkit me titull “*Mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri përgjatë vitit 2016*”, konstatohet se “*Nga monitorimi në terren, i bërë nga KSHH, për respektimin e të drejtës së jetës, ofrimi i shërbimeve shëndetësore, të*

⁷ <http://www.zhvillimiurban.gov.al/al/programi/konsultimi-strategjise-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim-2015-2020>

⁸ Këto konkluzione kanë dalë nga takimet dhe monitorimet në terren të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe stafit të Zyrës së Komisionerit.

⁹ Evidentuar nga ankesat e regjistruara në Zyrën e KMD-së.

arsimit, strehimit dhe punësimit të komunitetit rom dhe egjiptian në bashkitë Tiranë, Durrës, Fier, Berat, Shkodër dhe Krujë, ka rezultuar se këta shtetas nuk kanë informacionin minimal për të drejtat dhe mjetet e kërimit të tyre. Gjithashtu, një pjesë e tyre nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm ose e braktisin atë. Një numër i konsiderueshëm personash punojnë si mbledhës individual të mbetjeve urbane, pasi politikat publike për ofrimin e kurseve profesionale dhe orientimit drejt tregut të punës, nuk kanë rezultuar efektive ndaj këtyre komuniteteve. Kjo situatë i vendos këto komunitete përballë kushteve të jetës në minimumin jetik, i cili ende nuk është përcaktuar me akte ligjore dhe nënligjore nga shteti. ... Si pasojë e stigmatizimit, mungesës së informacionit mbi programet e punësimit, mungesës së dokumenteve personale dhe administrative, distancës me vendet e punës apo shkollat, romët dhe egjiptianët përballen me pengesa në punësim.”¹⁰.

Punësimi, formimi profesional, njohja me të drejtat që asaj i jep ligji, janë disa nga rrugët që do të çojnë në integrimin e saj në shoqëri. Fëmijët romë që punojnë në rrugë mbeten shqetësuar, pavarësisht përpjekjeve për të reduktuar këtë fenomen duke marrë në mbrojtje fëmijët e rrugës dhe familjet e tyre.

Shërbimet. Një tjetër problem me të cilin përballen komuniteti rom dhe egjiptian, është përfitimi I asistencës ligjore falas. Duhet të rritet niveli i informacionit të këtij komuniteti mbi këto të drejta, mbështetur në ligjin “Për ndihmën juridike”, (ligj nr. 77/2014 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar) si: përjashtimi i individit nga pagesa e taksës mbi aktet; përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore si në proceset civile ashtu edhe në ato administrative. Mungesa e këtij informacioni ka sjellë mosgëzimin e kësaj të drejte nga anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Aksesi në shërbimin urban është një tjetër problem për Romët dhe egjiptianët të cilët përballen me pengesa, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t’i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullsisë dhe institucionet shtetërore.

Mungesa e dokumenteve personale, librezës shëndetësore apo dokumenteve të vendbanimit, nuk i japin mundësinë këtij komuniteti të regjistrohen në sistemin e mbrojtjes sociale dhe të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, ku duhet theksuar rreziku i madh shëndetësor që ata kanë, për shkak të kushteve të jetës. Gjithashtu, puna informale që ata bëjnë nuk u siguron atyre përfitime nga skemat e sigurimeve shoqërore¹¹.

¹⁰ office@ahc.org.al

¹¹ Këto konkluzione kanë dalë nga takimet në terren të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjithashtu edhe nga ankesat e regjistruara në KMD.

Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton të drejta të plota për qytetarët. Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si "të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik", duke sanksionuar së bashku me nenin 18 parimin e barazisë pa diskriminim të të gjithë personave që banojnë në territorin e RSh- së. Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë specifike orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si shkak për ndalimin e diskriminimit (për të cilin pati një debat të gjerë gjatë realizimit të ndryshimeve kushtetuese), ndërkohë që Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" e realizon një gjë të tillë.

Shqipëria, ka ratifikuar një numër të gjerë marrëveshjesh ndërkombëtare, që kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut kanë krijuar kontekstin për promovimin e të drejtave të personave LGBTI. Mbrojtja e të drejtave të personave LGBTI është aktualisht pjesë e Udhërrëfyesit për 5 Prioritetet. Kuadri ligjor shqiptar kundër diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor (OSIGJ), mbështetet nga Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për të drejtat e personave LGBT, 2016-2020.

KMD konstaton se, në kushtet e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri, është konsideruar një hap pozitiv që gjykata në vitin 2015, la në fuqi vendimin e KMD-së "konstatim diskriminimi për shkak të orientimit seksual". Rasti është i bazuar në ankesën e dy shoqatave: Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI dhe Shoqata Pro Kauzës LGBT . Ky është vendimi i parë gjyqësor në Shqipëri pro komuniteti LGBTI.¹²

Nuk ka të dhëna zyrtare për popullsinë LGBT në Shqipëri. Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor tregon se të dhënat personale që i referohen orientimit seksual ose identitetit gjinor mund të mblidhen kur ky veprim është i nevojshme për realizimit e një qëllimi specifik, të ligjshëm dhe legjitim. Është e qartë që pa këtë lloj informacioni nuk mund të ketë një bazë solide për zhvillimin dhe zbatimin e politikave për të trajtuar intolerancën dhe diskriminimin e personave LGBT¹³.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të përmirësimit të legjislacionit, i cili garanton të drejta për LGBTI, ka ndërhyrë përmes rekomandimeve ligjore si poshtë:

Kodi Penal ndalon krimet e urrejtjes, të motivuara nga paragjykimet ndaj orientimit seksual dhe identitetit gjinor¹⁴, çdo formë diskriminimi nga ana e një zyrtari publik, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor të qytetarëve¹⁵, penalizon nxitjen e urrejtjes ose mosmarrëveshjeve

¹² "Oral Intervention" e KMD-së në Sesionin e CEDAW, mbajtur në Gjenevë në korrik 2016.

¹³ www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015.

¹⁴ Orientimi seksual dhe identiteti gjinor (OSIGJ) parashikohen si rrethana rënduese në vepra penale (Neni 50).

¹⁵ (neni 253).

mbi baza të orientimit seksual (neni 265). **Por:** Orientimit seksual dhe/ose identiteti gjinor nuk është përfshirë në nenin 119, i cili penalizon shpërndarjen e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike ndaj publikut, duke lënë të papërfshira materialet homofobe (Nenet 119 a dhe b); identiteti gjinor nuk është përfshirë në nenin 265, duke i lënë personat transgjinorë pa mbrojtje ligjore nga nxitja e urrejtjes; Kodi Penal parashikon akoma “*Marrëdhëniet e detyruara seksuale dhe homoseksuale dënohen me ligj*” (neni 102 / a) ndërkohë që, homoseksualiteti nuk është më një vepër penale; kriminalizimi i prostitucionit dhe aktivitetit seksual në vende publike ndëshkon edhe një pjesë të personave transgjinorë, të cilët janë të detyruar të punojnë si punonjës seksi.

Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim, në bazë të orientimit seksual dhe/apo identitetit gjinor (neni 9), "në orientimin dhe arsimin profesional, marrjen në punë dhe në ushtrimin e profesioneve të ndryshme, si dhe në kushtet e punësimit që lidhen me: shpërndarjen e punës, kryerjen e punës, shpërblimin, ndihmën shoqërore, disiplinën ose përfundimin e kontratës së punës". Ngacmimi moral dhe seksual dhe komentet poshtëruese, kundër dinjitetit të punonjësve dhe personalitetit të tij, janë të ndaluara me ligj (neni 32)¹⁶. Në rast të diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, punëdhënësi duhet të vërtetojë se ai/ajo nuk e ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë, ashtu siç ndodh dhe me rastin e ngacmimit seksual, ku barra e provës është për punëdhënësin ose kolegun që ka kryer ngacmimin.

Kodi i Procedurave Administrative ndalon diskriminimin në bazë të OSIGJ dhe zhvendos barrën e provës për institucionin publik, siç parashikohet në Ligjin e Mbrojtjes nga Diskriminimi (neni 32). Ligji mbi procedurën civile nuk e zhvendos barrën subjektivit të sipërcituar, por kërkon dëshmi nga viktimat e diskriminimit, pra barra e provës ndahet në mes pjesëtarëve. KMD ka bërë në vitin 2014, një rekomandim për amendime në Kodin e Procedurës Civile mbi zhvendosjen e barrës së provës për çështjet e diskriminimit. Ky rekomandim nuk është marrë në konsideratë në ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile.

Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” e ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual. Neni 5 i ligjit thekson se e drejta për arsimim është e garantuar për të gjithë, pavarësisht gjinisë dhe orientimit seksual. Ligji nuk përfshin identitetin gjinor në mënyrë eksplicite, por gjinia mund të nënkuptojë dhe t’i referohet identitetit gjinor.

Ndihma juridike ofrohet për ata individë të cilët "*kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile dhe administrative, por nuk disponojnë mjete financiare për të paguar për ndihmën juridike*" (Neni 13). Ligji prezantoi konceptin e Klinikave Ligjore Vendore¹⁷, të cilat duhet të

¹⁶ Ky rekomandim është bërë nga Avokati i Popullit.

¹⁷ Neni 12/1 Klinikat ligjore vendore (Shtuar me ligjin nr. 143, datë 2.5.2013) (Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.77 datë 10.07.2014) parashikon “1. Klinikat ligjore vendore kanë si qëllim të veprimtarisë së tyre ofrimin e ndihmës juridike parësore. 2. Klinikat ligjore vendore japin asistencë edhe për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, si dhe dokumenteve që duhet t’i bashkëlidhen formularit tip të kërkesës. 3. Klinikat ligjore vendore

sigurojnë ndihmë për grupet e rrezikuara në njësitë e qeverisjes vendore. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike është përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike.

Kushtetuta e Shqipërisë njeh të drejtën e martesës dhe të drejtën e familjes për të gjithë (neni 53), por Kodi i Familjes nuk e njeh. Ai parashikon të drejtën e martesës dhe bashkëjetesës vetëm për çiftet heteroseksuale (neni 163). Drafti për ndryshimet në Kodin e Familjes që do të mundësonin rregullimin ligjor të bashkëjetetës, nuk është futur në axhendat e institucioneve përgjegjëse.

Shqipëria është një shoqëri në kulturën e së cilës seksualiteti kuptohet në termat e kategorive të ngurta, të “burrit” dhe “gruas”. Në një sondazh të vitit 2015, të opinionit publik për të drejtat e LGBTI në Ballkanin Perëndimor, Instituti Kombëtar Demokratik konstatoi se shqiptarët janë aq shumë homofobë sa 92% e tyre nuk do të ndërvepronin me personat LGBTI dhe gati gjysma pohoi se homoseksualiteti është sëmundje¹⁸. Shumica e njerëzve nuk njohin persona LGBTI. Prandaj, ekziston mungesa e të kuptuarit të nevojave të personave LGBTI në përgjithësi. Në qytetet e urbanizuara, sidomos në kryeqytet, duket toleranca ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual ose identitet të ndryshëm gjinor, në krahasim me zonat rurale, të cilat janë më konservatore dhe ku ky komunitet përballet me shumë sfida¹⁹.

Qendra “Streha” për personat LGBTI, që mbështetet tërësisht nga donacionet, vazhdon të ofrojë shërbime për anëtarët e komunitetit në nevojë. Në shkurt, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit mes ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe strehës. Në maj u organizua një event për mbledhjen e burimeve të nevojshme për të vazhduar veprimtarinë e strehës. Po ashtu, në maj, janë organizuar një sërë evente rreth ditës ndërkombëtare kundër homofobisë, transfobisë dhe biofobisë. Ndërgjegjësimi i publikut dhe pranimi në shoqëri mbetet në nivele të ulëta, ne veçanti në zonat rurale. Ndryshimet në kodin e familjes, për të prezantuar konceptin e bashkëjetesës së çifteve të të njëjtit seks, ende nuk janë miratuar²⁰.

Në fushën e krimeve të urrejtjes, Policia e Shtetit ka caktuar pikën fokale. Gjithsesi, numri i rasteve të raportuara mbetet i papërfillshëm dhe nuk është filluar asnjë ndjekje penale. Vijon mungesa e mbledhjes së të dhënave për krimet e urrejtjes. KMD-ja ka trajtuar çështje të gjuhës së urrejtjes që shënjestrojnë komunitetin LGBTI edhe gjatë vitit 2016 dhe në dy raste, KMD-ja ka vendosur gjoba ndaj autorëve. KMD-ja vijon të organizojë fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete trajnuese. Jurisprudenca anti-diskriminim duhet të zhvillohet më tej dhe zbatimi i saj duhet të përmirësohet. Në fushën e të drejtave të personave lesbike, homoseksualë, biseksualë,

organizohen, të paktën, në të njëjtin numër me atë të gjykatave të apelit. Struktura dhe organika e klinikave ligjore vendore është pjesë e strukturës dhe organikës së Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike dhe sekretariatit të tij. 4. Rregullat e hollësishme për funksionimin e klinikave ligjore vendore, si dhe për ofrimin prej tyre të ndihmës juridike parësore, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike”.

¹⁸<https://www.ndi.org/>

¹⁹<https://www.ndi.org/>

²⁰ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2016>

transeksualë dhe ndërgjinorë (LGBTI), është miratuar në maj një plan veprimi për të drejtat e LGBTI 2016- 2020. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë fusha të mbrojtura nga diskriminimi në Kodin e Punës²¹.

Edukimi - Të drejtat e personave LGBTI dhe çështjet OSIGJ nuk përfshihen në programin mësimor të përgjithshëm kombëtar, pasi seksualiteti, në përgjithësi, konsiderohet si një çështje e ndjeshme. Mungesa e përgjithshme e edukimit mbi seksin dhe seksualitetin në shkolla, të çështjeve të lidhura në mënyrë specifike me komunitetin LGBTI, kombinuar kjo me mungesën e informacionit dhe udhëzimeve nga prindërit, është e dëmshme për vetëvlerësimin e të rinjve LGBTI. Në institucionet arsimore, është konstatuar se personat LGBTI janë objekt i diskriminimit, bullizmit dhe abuzimit. Mjediset shkollore kanë tendencë të imponojnë të kuptuarit tradicional të roleve gjinore. Disa studentë LGBTI braktisin shkollën për shkak të bullizmit dhe ngacmimit. Paragjykimi vjen nga studentët dhe nga mësuesit. Dëshmia e personave LGBTI, në përvojat e tyre në mjediset arsimore, portretizon një mjedis të ashpër. Sondazhet raportojnë nivele të larta të dhunës fizike, ngacmimit seksual dhe abuzimit verbal²². Rezultati është se njerëzit LGBTI nuk ndjehen të sigurt. Ata përjetojnë dhunë, braktisin shkollën dhe kanë mendime vetëvrasjeje. Sipas studimit “Eksperiencat e diskriminimit të adoleshentëve në shkollë”, i kryer nga Ambasada PINK në vitin 2015, rezulton se “*të anketuarit kanë hasur ngacmime në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Studentët LGBTI raportojnë se ambientet shkollore nuk janë të sigurta që ata të jenë të hapur lidhur me OSIGJ në shkollë. Ata raportojnë se përjetojnë stigmë sociale, diskriminim dhe sulme fizike për shkak të statusit të tyre LGBTI*”.

Shëndetësia, është një nga fushat kryesore të shqetësimit për komunitetin LGBTI. Shërbimet shëndetësore, në lidhje me shëndetin riprodhues dhe seksual, i drejtohen vetëm heteroseksualëve. Aksesit në kujdesin shëndetësor është problem, veçanërisht për transgjitorët, pasi mungojnë shërbimet shëndetësore të nevojshme për ta. Kirurgjia e ndryshimit të gjinisë nuk mundësohet në Shqipëri dhe si pasojë transgjitorët duhet të gjejnë mundësi për këtë ndërhyrje jashtë vendit. Në aspektin e legjislacionit, personat transgjitorë, nuk mund të ndryshojnë seksin e tyre në dokumentet ligjore, nëse ato nuk kanë bërë ndërhyrjen për ndryshimin e gjinisë. Ka vetëm një numër të kufizuar të OJF-ve që ofrojnë shërbime shëndetësore miqësore ndaj personave LGBTI, duke përfshirë parandalimin dhe trajtimin e HIV-it. Mungesa e shërbimeve të kujdesit shëndetësor ndaj personave LGBTI, shoqërohet dhe me qëndrimet dhe praktikat diskriminuese nga institucionet mjekësore. Në radhët e personelit mjekësor, ekziston një pjesë e tyre që e konsiderojnë homoseksualitetin, si sëmundje dhe marrëdhëniet ndërmjet të njëjtës gjini si të pamoralshme. Personat LGBTI hasin shumë pengesa në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke theksuar rastet e paragjyqimeve dhe diskriminimit nga ana e stafit mjekësor. Si pasojë, e këtyre qëndrimeve negative dhe diskriminuese, kufizohet aksesit në shërbimet shëndetësore për personat LGBTI.

²¹ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2016>

²² Ambasada Pink/LGBT Pro Shqipëri

Personat LGBTI përballen me sfida në punësim. Edhe pse është i ndaluar me ligj, diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në vendin e punës, ndodh rëndom. Studimi i HeadHunterGroup i 2016-tës, mbi punësimin në sektorin privat, tregon se kompanitë në Shqipëri kanë shumë pak politika në burimet njerëzore dhe praktika për të mbrojtur dhe për të mbështetur të drejtat dhe dinjitetin e punëkërkesve dhe punonjësve LGBTI (HeadHunter 2016). Sfidat përfshijnë vështirësi në gjetjen e punës, në rastet kur personi është i hapur në lidhje me orientimin e tij/saj seksual dhe gjithashtu stresin se mos merret vesh orientimi i tij/saj seksual nga të tjerët, ashtu dhe në rastet kur personi nuk është i hapur lidhur me orientimin seksual. Ata të cilët, në pamje të jashtme, shfaqen brenda kufijve heteronormativë dhe mund ta fshehin orientimin e tyre seksual apo identitetin gjinor, ndihen më të sigurtë, megjithatë ata i ngarkon kjo fshehtësi.

Shumë persona LGBTI zgjedhin të mos dalin hapur në mënyrë që të shmangin diskriminimin dhe stigmën në punë. Diskriminimi kundrejt personave LGBTI në punë nuk ka marrë ndonjëherë vëmendjen e duhur, pavarësisht ekzistencës së neneve lidhur me LGBTI-të në vendin e punës. Edhe pse ka vende pune, që janë më miqësore ndaj personave LGBTI, përsëri mungojnë modelet pozitive të personave, që janë të hapur për orientimin e tyre seksual dhe identitetin e tyre gjinor në punë. Ky është reflektimi i mjedisit armiqësor në punë. Punonjësit LGBTI nuk ndihen konfort që të dalin hapur lidhur me OSIGJ në punë dhe vihet re një numër i kufizuar i vendeve të punës, për shkak të diskriminimit dhe përjashtimit. Personat transgjinor, të cilët nuk mund të fshehin lehtë identitetin e tyre gjinor, vuajnë diskriminimin më të madh në punësim dhe shpesh detyrohen të punojnë si punëtorë seksi, çka është e paligjshme. Ata nuk mund të marrin dokumentacion, që dëshmon gjininë e tyre të preferuar, çka do të mundësonte që të kërkonin punë. Shumë prej tyre janë subjekt i dhunës dhe shantazheve dhe rrezikohen nga varfëria²³.

Media. Ka mungesë të raportimit mediatik të incidenteve të ngacmimit, diskriminimit dhe dhunës ndaj personave LGBTI. Media nuk ka informacion dhe trajnime lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut dhe të OSIGJ, në veçanti.²⁴

Kushtetuta dhe legjislacioni përkatës janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke garantuar liritë individuale, përfshirë këtu edhe të drejtën e privatësisë, lirinë e shprehjes dhe sanksionet kundër nxitjes së urrejtjes. Rregullat mbi **gjuhën e urrejtjes** janë në pajtim me të standardet ndërkombëtare. Ka pasur tri raste të gjuhës së urrejtjes, të regjistruara nga policia dhe prokuroria në periudhën e raportimit. Pesë ankesa për gjuhën e urrejtjes janë dorëzuar në Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për arsye të orientimit seksual. Rregullat mbi **gjuhën e urrejtjes** janë në pajtim me të standardet ndërkombëtare. Ka pasur tri raste të gjuhës së urrejtjes, të regjistruara nga policia dhe prokuroria në periudhën e raportimit.

²³ /lp.experteer.com/executive-jobs-com/ HeadHunter 2016

²⁴ Marrë nga Raporti i OMSA.

Pesë ankesa për gjuhën e urrejtjes janë dorëzuar në Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për arsye të orientimit seksual.²⁵

Diskriminimi për shkak të Aftësisë së Kufizuar

Njohja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e të drejtave të njeriut, të njohura dhe të sanksionuara në dokumenta të rëndësishëm ndërkombëtarë, është një hap i rëndësishëm për mbrojtjen dhe avancimin e këtyre të drejtave dhe përfaqësojnë detyrime për t'u zbatuar nga çdo shtet, që aspiron për një shoqëri demokratike dhe në zhvillim. Për këtë arsye, ata duhet të përfshihen në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.

Për të rritur në të ardhmen nivelin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, është i domosdoshëm informimi i vazhdueshëm për ndryshimet e planifikuara nga institucionet politikbërëse. Gjithashtu, faktor i rëndësishëm mbetet ngritja e kapaciteteve si e personave me aftësi të kufizuara, për t'u bërë pjesë aktive dhe kontribuese e këtij procesi, ashtu edhe ajo e përfaqësuesve të institucioneve për të marrë njohuri dhe përvoja për rëndësinë e formulimit të politikave me pjesëmarrje.

Aftësia e kufizuar nuk qëndron te individi, ajo lidhet me ndërveprimin midis personit të dëmtuar dhe mjedisit që e rrethon atë. Shoqëria dhe institucionet duhet të udhëhiqen nga vullneti dhe ndjenja e detyrës për të ndërtuar një mjedis dashamirës dhe të përshtatshëm, që çdo individ të mund të zhvillohet dhe të marrë pjesë në çdo fushë të jetës.

Në fushën e personave me aftësi të kufizuara, kuadri ligjor është në fuqi dhe është në përputhje të pjesshme me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD). Një sërë nenesh, në veçanti, neni 12 i CRPD-së, nuk janë transpozuar ende në legjislacionin kombëtar. Një vendim i qeverisë, për të hequr barrierat mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike, u miratua në dhjetor. Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2016-2020, u miratua në qershor. Gjithsesi, bashkitë dhe shumica e ministrive të linjave ende nuk kanë emëruar një zyrtar përgjegjës për çështjet e aftësive të kufizuara, siç parashikohet me ligj.

Në përgjithësi, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në arsim, punësim, kujdes shëndetësor, shërbime sociale dhe vendim-marrje, përfshirë pengesat që nuk i lejojnë të ushtrojnë lirshëm të drejtën e votës. Monitorimi i zbatimit të masave që lidhen me aftësitë e kufizuara pengohet nga mungesa e të dhënave në dispozicion. Pavarësisht disa përpjekjeve, numri i mësuesve ndihmës nëpër shkolla, për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara, është i pamjaftueshëm²⁶.

²⁵ Marrë nga “Raporti i vitit 2016 për Shqipërinë që Shoqëron Dokumentin Komunikim i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve” i Komisionit Evropian, faqe 26.

²⁶ <http://www.integrimit.gov.al/al/dokumente/raportet-e-ke-per-shqiperine/raporti-i-ke-2016>

Shqipëria është nënshkruese e disa dokumentave ndërkombëtare, që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kemi një angazhim të shtetit Shqiptar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, me ratifikimin e KDPAK²⁷. Ka një progres të dukshëm të realizuar, sa i takon ngritjes së një baze ligjore, e cila vjen në përputhje me standartet e kërkuara nga KDPAK dhe ligjit Nr. 93/2014 datë 24.07.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Shqipëria ka hartuar raportin e pare për zbatimin e KDPAK në maj 2015. Vlen të përmendet, përmirësimi i Ligjit Nr. 9355 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016 – 2020, projektligji “Për Strehimin Social”, në të cilin përfshihet edhe ky komunitet, si dhe një fokusim në ndryshimet ligjore në fushën e punësimit. Megjithatë, duhet përmendur, se të gjithë këto ndryshime kanë ndodhur në një hark të shkurtër kohor e për pasojë është e vështirë që të kemi në këtë fazë një vlerësim të impaktit që këto ligje do të kenë në realitet në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Aksesueshmëria në rrugë dhe në trotuare është akoma problem për personat në karrige me rrota, apo personat që nuk shikojnë dhe përdorin shkopin e bardhë. Megjithë ndryshimet e bëra, shumë pak trotuare janë përshtatur, ata mund të jenë të ngushtë dhe shpesh sipërfaqja e tyre nuk është e njëtrajtshme. Transporti publik mbetet i paaksesueshëm dhe një problem i madh për këta persona. Edhe pse qeveria ka miratuar standartet përkatëse, ata nuk zbatohen në praktikë.

Në kryqëzimet e rrugëve apo në transportin publik nuk ekzistojnë sinjalizimet zanore dhe stacionet e autobusit janë të pashënuar, duke e bërë orientimin të vështirë. Shumë pak rrugë dhe ndërtesa publike përfshijnë shenja të ngritura ose të përshtatura për të verbërit, si dhe mungojnë mjetet ndihmëse si shkopinj të bardhë, qentë orientues dhe qentë ndihmës.

Aspektet kryesore të së drejtës për strehim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara përfshijnë aksesueshmërinë fizike të banesës, banesën me shërbime mbështetëse, strehimin social dhe subvencionet. Personat me aftësi të kufizuara mund të marrin me qira apo të blejnë vetëm një numër të vogël banesash dhe apartamentesh, që nuk kërkojnë shpenzime shtesë për përmirësimin e aksesueshmërisë (p.sh. duke ndërtuar rampa, duke zgjeruar hapësirat e hyrjeve, duke ulur lartësinë e çelësave të dritave, etj.). Në vitin 2008, Këshilli i Ministrave nxori një vendim “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, i cili parashikon standartet e aksesueshmërisë dhe normat që duhet të zbatohen në industrinë e ndërtimit (veçanërisht në lidhje me aksesin nëpër ndërtesa, rrugë dhe mjedise të tjera të brendshme dhe të jashtme). Megjithatë, këto standarde nuk mbikëqyren në mënyrë sistematike dhe zbatimi i tyre nuk monitorohet.

²⁷ Ligji nr. 108/2012 datë 15.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Qeveria ofron disa programe për strehimin që përfshijnë banesa sociale me qira, banesa me kosto të ulët dhe truall të pajisur me infrastrukturë²⁸. Përveç kësaj, programet e mëposhtme kontribuojnë për ofrimin e strehimit social: bonuse strehimi, subvencione qiraje, subvencionim të kredisë, grant i menjëhershëm për banesa me kosto të ulët dhe grante të vogla. Gjithashtu, duhet theksuar se personat me aftësi të kufizuara përfitojnë kushte favorizuese për legalizimin e ndërtesave të tyre të banimit, nëse do të jetë e nevojshme²⁹. Megjithatë, strategjia kombëtare e strehimit pranon faktin se "grupet vulnerabël nuk përfitojnë nga këto programe, karakteristikat demografike të të cilëve përbëjnë një pengesë të qartë për të përballuar dhe për të pasur akses në programet e strehimit"³⁰. Ligji "*Për programet sociale të strehimit*" ka identifikuar personat me aftësi të kufizuara si një grup i veçantë me prioritet për programet sociale të strehimit, përkatësisht për subvencionim të qirasë dhe subvencionimet për interesat e kredive.

Kjo është specifikuar më tej në një Vendim të Këshillit të Ministrave, që u jep përparësi në strehim personave me dëmtim të plotë ose të pjesshëm të shikimit, të cilët e kanë të pamundur të punojnë në kushte normale pune, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve të pajisur me vërtetim nga komisioni mjekësor (KMCAP), personave me aftësi të kufizuara të paaftë për punë dhe që kanë një vërtetim nga KMCAP-ja dhe personat e deklaruar si invalidë pune³¹. Përcaktimi, bazuar në qasjen mjekësore, i përfitimeve dhe kriterëve për të hyrë në programet publike nuk është në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Bazuar në ndryshimet që kanë ndodhur me ligjin 44/2016 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"*, i ndryshuar, konkretisht neni 42/3, kanë gjetur pasqyrim konceptet e modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar me grup/komision vlerësimi shumëdisiplinor. Në bazë të ligjit, kjo procedurë e re do të pilotohet në njësi të caktuara të qeverisjes vendore. Po ashtu, janë miratuar edhe disa akte nënligjore në zbatim të ndryshimit të mësipërm.³²Po ashtu, nuk ka komplekse ose njësi banimi ku personat me aftësi të kufizuara mund të jetojnë në mënyrë të pavarur me shërbime të personalizuara mbështetëse.

²⁸Ligji nr. 9232.

²⁹VKM nr.488, datë 22 korrik 2014, "Përpërcaktimin e çmimitfavorizueshtëshitjessëparcelësndërtimorepërndërtimet pa leje me funksionbanimidhetëpërzier, tësubjekteveqëpërfitojnëfaljetëpagesës, sidhetëmënyrës e afatevetëpagesës".

³⁰ Qeveria e Shqipërisë, *Strategjia Kombëtare e Strehimit*, maj 2015, f. 5.

³¹VKM nr. 526 "Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara të cilët trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit".

³²Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 431, datë 8.6.2016 "*Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot*" dhe Udhëzim i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, nr. 22, datë 7.10.2016 "*Mbi përcaktimin e masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal*". Dhe Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, nr. 21, datë 07.10.2016 "*Për miratimin e kriterëve për vlerëziminbio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot*"

Ka pasur diskriminimi nga shoqëria dhe stigmatizimi i personave me aftësi të kufizuara mendore dhe forma të tjera të aftësisë së kufizuar.³³

Aksesi në drejtësi mbetet i rëndësishëm edhe për shkak të pamundësisë së personave me aftësi të kufizuar për një pjesmarrje dinjitoze apo përfaqësim të sigurtë në proceset gjyqësore (për shkak të mungesës së infrastrukturës në ndërtesat e gjykatave apo prokurorive, por edhe lidhur me nivelin profesional të trajtimit të çështjeve të aftësisë së kufizuar nga aktorët e sistemit të drejtësisë. Shkolla e Magjistraturës ka realizuar në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhduar, seminare trajnuese me temë “Jurisprudence e GJEDNJ lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa e OKB dhe legjislacioni shqiptar lidhur me PAK dhe roli i sistemit të drejtësisë”, ku mori pjesë edhe Komisioneri.

Diskriminimi për shkak të gjinisë

Arritja e barazisë gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, tashmë artikulohej qartësisht mes prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për zhvillim, në një tërësi dokumentash e programesh kombëtare,

Jetojmë në një shoqëri, ku pavarësisht ndryshimeve pozitive e progresit të arritur, sjelljet stereotipike paragjyqëse dhe modelet që nxisin veprime të dhunshme e diskriminuese, nuk mungojnë në përditshmërinë tonë. Ndaj është i nevojshëm harmonizimi mëtejshëm i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar; garantimi i trajtimit të barabartë e pa diskriminim i të gjithë individëve në shoqëri; marrja në konsideratë dhe trajtimi me prioritet të nevojave të grupeve vulnerabël (sidomos të grave kryefamiljare, grave të dhunuara, grave me aftësi të kufizuara, vajzave-nëna, grave romë dhe egjiptiane, grave të moshuara, grave LGBTI); zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara dhe përmirësimi i efektivitetit të tyre në përputhje me standartet e kërkuara; sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të të gjithë anëtarëve në familje të dëmtuar nga dhuna e ushtruar; përgatitja e një gjenerate të re me një mendësi të hapur, pa paragjykimet e stereotipe gjinore, si dhe tërësisht kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Diskriminimi ndaj grave dhe dhuna në familje vazhdojnë të përpëjnë një ndër shkeljet më domethënëse të të drejtave të njeriut.³⁴

KMD ka konstatuar nga veprimtaria e tij se, një nga fushat kryesore të diskriminimit me bazë gjinore ka të bëjë me dështimin e institucioneve publike për të vërejtur të drejtën e individëve për të pasur akses në mallra dhe shërbime. Megjithatë, vihet re se numri kërkesave të diskriminimit

³³ Marrë nga Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “ALBANIA 2015 HUMAN RIGHTS REPORT”, faqe 24.

³⁴ Marrë nga Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “ALBANIA 2015 HUMAN RIGHTS REPORT”, faqe 1.

me bazë gjinore në tërësi është i ulët në krahasim me shkaqe të tjera të diskriminimit. Mbetet problematike diskriminimin në punësim për shkak të shtatzënisë, lindjes, gjendjes shëndetësore ose marrëdhënie familjare si nga institucionet publike ashtu edhe nga subjektet private.

Sjellim në vëmendje rastet e diskriminimit të tërthortë (pasoja diskriminuese që rrjedhin nga zbatimi i ligjeve dhe praktikave në dukje neutrale), ku shpesh viktimat janë vajza dhe gra si dhe diskriminimin e shumëfishtë (më shumë të rrezikuara janë vajzat rome dhe egjiptiane, kryesisht ato nga familje të varfra ose me aftësi të kufizuara). Mbetet ende problematik denoncimi i ngacmimit seksual edhe pse ajo është e ndaluar me ligj në ambientet e punës e në arsim.

Dhuna në familje si një nga format e dhunës me bazë gjinore, mbetet një nga fenomenet më shqetësuese që gratë gratë përballin në shoqërinë tonë. Pavarësisht zhvillimeve dhe ndryshimeve në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit civil administrativ, efektiviteti i zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje ka nevojë të forcohet më tej.

Konventa e Këshillit të Europës "Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje " e përkufizon dhunën kundër grave si "*një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit të grave ...*". Ka raste të dhunës që janë trajtuar si raste diskriminimi, sidomos trajtimi me dinjitet e pa i diskriminuar viktimat e dhunës në familje, në qendrat që ofrojnë ndihmë, por edhe nga institucionet që janë pjesë e Mekanizmit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje. **KMD nuk është pjesë e këtij mekanizmi.**

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë³⁵, për periudhën janar-shtator 2016, janë raportuar 3195 raste dhune në familje, duke shënuar rritje në krahasim me vitin 2015.

Sipas të dhënave të Policisë së Shtetit, për vitin 2016, janë raportuar 4163 raste dhune dhe krimi në familje. Nga këto 3062 janë gra/vajza të dëmtuara nga dhuna, ose 78% e nr. total të rasteve të raportuara. 22% janë burra/djem dhe 186 janë të mitur. 16 raste janë regjistruar me vrasje, ku 11 janë gra/vajza dhe 3 të mitur³⁶.

Sipas Raportit të *Amnesty International 2015/ 2016*, lidhur me dhunën ndaj grave dhe vajzave, Policia e Shtetit ka raportuar 1,696 raste të dhunës në familje në gjashtë muajt e parë të vitit, duke kërkuar 993 kërkesa për urdhra mbrojtje. Nga 406 kërkesa të paraqitura në gjykatat e kryeqytetit mes janarit dhe gushtit, vetëm 118 urdhra janë lëshuar, ndërkohë 251 aplikantë kanë tërhequr kërkesën e tyre, apo nuk kanë ndjekur proceset gjyqësore për shkak të presionit nga abuzuesit ose anëtarët e familjes së tyre. Në Tiranë, mes janarit dhe qershorit, të pandehurit janë dënuar për dhunë në familje në 185 nga 190 ndjekje penale; shumica kanë pranuar fajësinë³⁷

Në drejtim të parandalimit dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje,

³⁵<http://out.easycounter.com/external/sociale.gov.al>

³⁶ drejtorite-e-pergjithshme/drejtoria-e-pergjithshme-e-policise-se-shtetit

³⁷ Marrë nga "*Amnesty International Report 2015/ 2016*", paragrafi "Dhuna ndaj grave dhe vajzave", faqe 64.

megjithëse ka pasur përmirësim të ndjeshëm sidomos në kuadrin ligjor, ende duhet të ndërmerren një sërë veprimesh për përmbushjen e kërkesave të konventave ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe për të treguar tolerancë zero ndaj dhunës. Në këtë drejtim duhet të merren masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës, duke iu siguruar atyre ndihmë ligjore falas, duke përfshirë zonat rurale dhe ato të largëta, si dhe duke siguruar shërbim online 24 orë.³⁸

KMD, në trajtimin e rasteve të diskriminimit ndër vite ka konstatuar se numri i ankesave për diskriminim për shkak të gjinisë kryesisht është i ulët. Referuar ankesave të shqyrtuara, në rastet kur KMD ka konstatuar diskriminimi, rezulton se viktimat janë kryesisht gratë.³⁹

KMD dëshiron të sjellë në vëmendje se ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri", miratuar në vitin 2008, 2 vjet para miratimit të LMD, nuk përcakton një institucion monitorues si garantues për zbatimin e ligjit. Ndërsa LPD përcakton Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur publik që ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD është institucion garantues, kur pabarazia shkakton një sjellje diskriminuese. Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikon gjininë si një prej bazave të mbrojtura nga diskriminimi, që ka gjithashtu edhe dispozita të veçanta për mbrojtjen e barazisë gjinore. **Në këtë drejtim, KMD konsideron se ai duhet të jetë autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit 9970/2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".**

Lidhur me punësimin, struktura e punësimit sipas statusit të punësimit tregon se 42,6% e të punësuarve janë punonjës, 31,8% janë punonjës kontribues në familje dhe 25,6% janë të vetëpunësuar. Midis të vetëpunësuarve dhe punonjësve, meshkujt dominojnë me përkatësisht 57,2% dhe 70,5%. Ndërkohë, femrat kanë 1,3 herë më shumë gjasa se meshkujt që të jenë punonjëse kontribuese në familje, një situatë që i vendos ato në varësi ekonomike dhe pengon fuqizimin e tyre ekonomik.

“22 për qind e grave joaktive në punë merren me punë shtëpie, ndërsa kjo ndodh në vetëm 0.2 për qind të rasteve të burrave joaktiv në punë, përmendet në raport. Thuhet gjithashtu se të rinjtë e moshës 15-29 vjeç kanë gati dy herë më shumë gjasa (53 për qind) të jenë në kërkim të punës, sesa të rejat (21 për qind), të cilat mendohet se tërhiqen për t’u kujdesur për familjen⁴⁰.

Gratë mbizotërojnë në sektorët e prodhimit të industrisë së lehtë dhe shërbimet jashtë tregut, një tendencë që ka ardhur duke u rritur kohët e fundit. Gratë janë të përqendruara në sektorë si shëndetësia dhe arsimi dhe në një farë mase përfaqësohen edhe në shërbime, shitje me pakicë dhe tregti. Ato kanë gjithashtu më pak gjasa të jenë në pozicione të larta drejtuese, vetëm 14,6

³⁸ Vëzhgime Përfundimtare mbi Raportin e Katërt Periodik të Shqipërisë, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), 25 korrik 2016, faqe 6.

³⁹ “*Oral Intervention*” e KMD-së në Sesionin e CEDAW, mbajtur në Gjeneve, korrik 2016.

⁴⁰ <https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>, analizë e thelluar e PNUD dhe UN Women për Shqipërinë.

për qind. Hendeku gjinor i pagave është po ashtu jo i plotë në Shqipëri⁴¹. Kërkohej që të merren masa për një vlerësim më të mirë dhe për të zvogëluar hendekun gjinor të pagave, në veçanti në sektorin privat, duke zbatuar në mënyrë efektive parimin e pagesës së barabartë për punë me vlerë të barabartë.⁴²

Në lidhje me arsimin, shqetësues vazhdon të mbetet fakti që frekuentimi i shkollës nga ana e vajzave vazhdon të jetë më i ulët në krahasim me djemtë, ndërsa braktisja e shkollës nga vajzat dhe veçanërisht nga vajza që i përkasin grupeve të pakicave, për sa i përket arsimit të mesëm vazhdon të mbetet disproporcionalisht e lartë. Akses të kufizuar në edukim vazhdojnë të kenë vajzat romë dhe egjiptiane, vajzat me aftësi të kufizuar, si dhe fëmijët të cilët jetojnë në zona rurale dhe të largëta, kjo për shkak të infrastrukturës së dobët shkollore dhe mungesa e mësuesve.⁴³

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standartet dhe kërkesat ndërkombëtare është një proces kyç për të trajtuar më mirë nevojat gjinore të grave/vajzave dhe burrave/djemve në shoqëri. Në këtë kuadër një tërësi ligjesh, politikash, strategjish e programesh sektoriale janë rishikuar dhe përmirësuar nga perspektiva gjinore. Megjithatë, duhet të ndërmerren hapa të mëtejshëm, për zbatimin e suksesshëm të legjislacionit e politikave të përmirësuara. Rreziku i hartimit të politikave ose strategjive të reja të pandjeshme nga këndvështrimi gjinor duhet të shmanget, ndaj dhe përdorimi i analizës gjinore si instrument vlerësimi, përpara ndërhyrjeve të tilla për të gjitha grupet në nevojë, është domosdoshmëri. Po kështu proceset/mekanizmat e rregullta monitoruese, për të evidentuar se si janë përmbushur nevojat e grave/vajzave dhe burrave/djemve ende mungojnë.

Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të BE dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit evropian. Lënia jashtë vëmendjes apo mos trajtimi me kujdes ityre, do të sillte për pasojë rrezikun e mos përfitimit maksimal të rreth 50% të popullsisë, nga progresi i arritur nëpërmjet reformave shoqërore, politike dhe ekonomike. Pabarazia gjinore, e cila evidentohet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Shqipëri, nëse nuk do të vihet në qendër të politikave sociale, do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, pasi jo vetëm nuk do të shfrytëzohet potenciali i plotë njerëzor i vendit, por arritjet nuk do t'i gëzojnë të gjitha grupet shoqërore. Për rrjedhojë, integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri, për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore.

⁴¹ <https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>, analizë e thelluar e PNUD dhe UN Women për Shqipërinë.

⁴² Vëzhgime Përfundimtare mbi Raportin e Katërt Periodik të Shqipërisë, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), 25 korrik 2016, faqe 9.

⁴³ Vëzhgime Përfundimtare mbi Raportin e Katërt Periodik të Shqipërisë, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), 25 korrik 2016, faqe 8.

KAPITULLI II

VEPRIMTARIA E KMD NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE

PROMOVIMIN E BARAZISË

II.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:


1. Shqyrtimit të çështjeve nga KMD.
2. Asistencës së viktimave në gjykatë.

II.1.1. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë: të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve, që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi; të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji; t`u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues; të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.



II.1.1.1. Çështje të trajtuara

Në periudhën nga 1 janar 2016 deri në 31 dhjetor 2016, KMD ka trajtuar gjithsej **239 çështje**, (216 ankesa dhe 23 çështje ex-officio). Nga këto 131 (120 ankesa dhe 11 çështje ex-officio) janë ankesa të reja, të regjistruara në vitin 2016. KMD ka dalë me vendim për 202 çështje të trajtuara gjatë vitit 2016 dhe ka vendosur sanksione me gjobë për 10 çështje, për mosplotësim të rekomandimeve të Komisionerit apo mosdhënie informacioni nga ana e subjekteve.



II.1.1.2. Ankuesit

Bazuar në nenin 32, pika 1/a/b, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesit janë: individ, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.




Gjatë vitit 2016, ka trajtuar 205 ankesa nga individtrajtuar 205 ankesa nga individë dhe grupe individësh dhe 11 të adresuara organizata me interesa legjitime.

Këto të fundit kanë ardhë nga organizata që mbrojnë interesat e komunitetit rom, egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI, gratë, fëmijët etj. Vlen të theksohet fakti se, bashkëpunimi me shoqërinë civile ka qënë mjaft i efektshëm për evidentimin e rasteve të pretenduara për diskriminim, ndërgjegjësimin e përmirësimin e situatave. **Gjatë viti 2016, 30 ankues janë asistuar nga organizatat e shoqërisë civile.** Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga organizatat e shoqërisë civile ka shërbyer si indicie apo informacion për KMD-në për inicimin kryesisht të çështjeve.

II.1.1.3. Çështje të nisura kryesisht


Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, KMD ka nisur me iniciativë 11 raste pas marrjes së informacionit të besueshëm gjatë vitit 2016. Këto çështje, KMD i ka filluar mbështetur në informacionin e marrë në media (në 11 raste), si dhe nga organizata që veprojnë në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi (12 raste). Organizatat të cilat kanë dhënë informacion për trajtimin e çështjeve me iniciativë, kanë qënë organizatat, të cilat ofrojnë shërbim ligjor falas për persona në nevojë, shërbim dhe mbrojtje të personave me aftësi të kufizuara, si dhe organizata, të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve në arsim.

Tabela më poshtë jep një panoramë të përgjithshme mbi rastet e trajtuara me iniciativë nga KMD gjatë vitit 2016:



II.1.1.4. Shpërndarja rajonale e ankesave

Edhe gjatë vitit 2016 ka pasë një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së. Qytetet nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave me pretendim diskriminim pranë KMD-së janë Korça, Tirana, Elbasani, Lezha, Fieri, Mati dhe zonat përreth tyre.



II.1.1.5. Shkaqet e pretenduara

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje një listë të hapur të shkaqeve, duke përfshirë dhe “çdo shkak tjetër”, gjithmonë në lidhje me cilësi individuale të personave. Në 62 raste ankuesit të cilët kanë paraqitur ankesë pranë zyrës së Komisionerit subjektet kanë pretenduar diskriminimin e shumëfishtë, për më shumë se një shkak diskriminimi.

Më poshtë do gjeni të pasqyruar tabelën me shpërndarjen e ankesave të vitit 2016 të ndarë sipas shkaqeve:

• Gjinia	6	• Gjendja shoqërore	8
• Raca	91	• Shtatzënia	6
• Ngjyra	2	• Përgjegjësia prindërore	1
• Etnia	26	• Moshë	9
• Gjuha	3	• Gjendja familjare	3
• Identiteti gjinor	2	• Gjendja martesore	2
• Orientimi seksual	5	• Vendbanimi	3
• Bindja politike	42	• Gjendja shëndetësore	21
• Bindja fetare	1	• Aftësi e kufizuar	26
• Bindja filozofike	3	• Përkatësia në grup të veçantë	8
• Gjendja ekonomike	61	• Çdo shkak tjetër	15
• Gjendja arsimore	17		


Siç shihet, raca⁴⁴ vazhdon të mbetet shkak kryesor për të cilin pretendohet diskriminim, por ka një rritje të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, bindjeve politike dhe aftësisë së kufizuar.

Mbeten në të njëjtin nivel ankesat për diskriminim për shkaqet e orientimit seksual, identitetit gjinor, gjendjes shëndetësore dhe racës.

⁴⁴ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

II.1.1.6. Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat

Gjatë vitit 2016 janë trajtuar nga Komisioneri 239 çështje(131 çështje të reja, për të cilat më poshtë do të gjeni grafikët mbi ndarjen sipas fushave kryesore të parashikuara nga ligji: arsim, punësim dhe të mira e shërbime.



Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Rastet e trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve (119) kanë qënë më të shumta në numër, krahasuar me dy fushat e tjera, kryesisht ndaj administratës publike(114) por edhe ndaj subjektet private(5). Kryesisht rastet adresojnë mohimin e përshtatjes së arsyeshme, mospërfitimin nga shërbimet dhe politikat sociale si ndihma ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, strehimit etj. Kjo është dhe arsyeja pse kjo fushë përmbledh 67 % të çështjeve të trajtuara.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit. Rastet e trajtuara në fushën e punësimit (84) janë kryesisht ndaj administratës publike (74) por edhe ndaj subjektet private(10). Çështjet e trajtuara në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, përkatësinë në një grupim të vecantë, gjendjen arsimore, racën, moshën.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit. Gjatë vitit 2016, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 36 çështje, në fushën e arsimit të gjitha kundër subjekteve publike. Rastet në fushën e arsimit kanë pasur përgjithësisht shkak diskriminimi racën, gjendjen shëndetësore, gjendjen ekonomike dhe aftësinë e kufizuar. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve ka të bëjë me mospranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, mosregjistrimit e fëmijëve të komunitetit rom në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme dhe problematikat e shpërndarjes së teskteve shkollore falas në shkollat 9-vjeçare, për familjet në nevojë.


II.1.1.7. Seanca dëgjimore dhe hetime administrative

Mbështetur në nenin 33, pika 8 e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:


- Ka dërguar **271 kërkesa për informacion**(214 kërkesa për informacion apo kujtesa për informacion, si dhe ka kërkuar ndaj subjekteve ankues në 57 raste informacion shtesë)
- Ka zhvilluar **87 inspektive**
- **Ka realizuar 39 seanca dëgjimore.** Vlen të theksohet fakti që Komisioneri ka dalë me vendim diskriminimi për 13 raste, pas zhvillimit të seancave dëgjimore.

II.1.1.8. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara

Nga 202 vendime të dhëna nga Komisioneri, rezulton se 57 prej tyre kanë konstatuar sjellje diskriminuese. Sjellim në vëmendje që edhe 11 rastet e zgjidhura me ndërmjetësim dhe 3 rastet kur është dhënë menjëherë rekomadim kanë qenë situata diskriminuese, por nuk janë shoqëruar me vendim diskriminimi, pasi janë zgjidhur gjatë procedurave të trajtimit të çështjeve.



Referuar vendimeve të dhëna nga Komisioneri konstatohet se gjatë shqyrtimit të ankesave në vitin 2016, janë dhënë 21 vendime, ku subjekti ankues ka qenë gra, 20 vendime, ku subjekti ankues ka qenë burra, 4 vendime, ku subjekti ankues ka qenë OJF dhe 12 vendime, ku çështja është iniciuar kryesisht nga Komisioneri (ex-officio).



II.1.2. Asistenca ndaj viktimave në proceset gjyqësore.

Gjatë vitit 2016 KMD ka asistuar në hartimin e dy kërkesë-padive me objekt konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin sipas ligjit në gjykatë dhe ka marrë pjesë në 45 procese gjyqësore.

Referuar statistikave të viteve të mëparshme, vihet re një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes në proceset gjyqësore në krahasim me vitet e mëparshme.

Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelore, statistika krahasuese lidhur me pjesëmarrjen e KMD-së në proceset gjyqësore nga 2012-2016 dhe roli i KMD-së në gjykim ndër vite.

	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Numri i proceseve gjyqësore për vit	3	6 (3 çështje të mbartura nga 2012)	18	37	45

Tabela Nr. 1: Numri total i pjesëmarrjes së KMD në proceset gjyqësore 2012 – 2016

	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Person i tretë	2	3	9	20	17
Palë e paditur	1	3	6	14	19
Kërkesa për Urdhra Ekzekutimi	-	-	3	3	9

Tabela Nr. 2: Roli i KMD në proceset gjyqësore 2012- 2016

Gjatë vitit 2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë në 45 procese gjyqësore, nga të cilat, si:

- ✚ *Palë e paditur në 19 (nëntëmbëdhjetë) procese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi apo pavlefshmëria absolute e vendimeve të KMD-së, pra kur subjektet e gjetur në shkelje të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” me vendim të KMD, i drejtohen gjykatës për kundërshtimin e aktit administrativ.*
- ✚ *Person i interesuar/palë e tretë në 17 (shtatëmbëdhjetë) procese gjyqësore, ku KMD është thirrur në gjykim nga gjykata kompetente për parashtrimin e një mendimi/opinionit të specializuar me shkrim, në çështje ku kërkohet dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë dhe kryesisht KMD ka zhvilluar një proces administrativ, duke dalë me vendim lidhur me çështjen. Në këto raste, KMD mbështet viktimën e diskriminimit me dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar diskriminimin përpara gjykatës.*
- ✚ *KMD kërkues për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga gjykata në 9 (nëntë) procese gjyqësore. Në përputhje me parashikimet ligjore, institucioni i është drejtuar gjykatës kompetente me kërkesa për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit për vendimet e KMD që vendosin sanksione me gjobë, me qëllim që të ekzekutohen gjobat nga subjektet të cilët, me vendim të Komisionerit, kanë kryer sjellje diskriminuese dhe nuk kanë ndrequr situatën diskriminuese, të vlerësuar rast pas rasti nga Komisioneri.*

II.2. Rekomandime legislative dhe opinione

Në zbatim të kompetencës ligjore të parashikuara nga neni 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku thuhet se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose **ndryshimin** apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, gjatë vitit 2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dërguar 5 (pesë) rekomandime legislative autoriteteve kompetente dhe 9 (njëmbëdhjetë) opinione, si më poshtë:

II.2. 1.Rekomandime Legislative

Viti	Numri i Rekomandimeve Legislative
2012	4
2013	2
2014	7
2015	3
2016	5

Tabela Nr. 3: Numri i Rekomandimeve Legislative të KMD nga 2012-2016

Rekomandime për projektligjin “Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

Rekomandimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Projektligjin “Për Pakicat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”⁴⁵.

Rekomandime për projektligjin “Për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve”.

Komente mbi projektligjin “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Mendime për projektligjin “Për programet sociale të strehimit”.

II.2.2.Opinione

Gjatë vitit 2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka hartuar dhe parashtruar opinione dhe mendime lidhur me:

1. Rekomandime lidhur me projektvendimin “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, 2016-2020”.
2. Rekomandime mbi zbatimin e Kodit të Transmetimeve dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive.⁴⁶
3. Rekomandime mbi zbatimin e Legjislacionit të Transmetimeve mbi transmetimin e lajmeve ku janë në qendër gratë dhe fëmijët.⁴⁷
4. Opinion për komente në kuadër të përmirësimit të “Draft-Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2012-2020”;
5. Opinion për “Përcaktimin e anëtarit në Grupin kombëtar të Koordinimit (GKZK), për të monitoruar zbatimin e ecurisë së Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI, 2016-2020”
6. Opinion për “Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2016 – 2020”⁴⁸.
7. Opinion për “Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016 – 2020”⁴⁹.
8. Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit CAT (UN CAT)

⁴⁵ Dërguar me anë të postës zyrtare elektronike ministrisë së punëve të Jashtme me 22.12.2016

⁴⁶ Dërguar me shkresën nr.929/1 Prot., datë 03.11.2016

⁴⁷ Dërguar me shkresën nr.1198 Prot., datë 30.12.2016

⁴⁸ Prot. 1145/1, datë 23.12.2016

⁴⁹ Prot. 406/1, datë 01.04.2016

9. Opinion për kryerje hetimi administrativ, ex-officio për diskriminimi e tërthortë të fëmijëve të sëmurë, për shkak të mungesës së barit L-Asparaginase, në pavionin e Onkohematogjisë në Shërbimin e Pediatriisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

II.3. Ndërgjegjësimi

II.3.1. Shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese dhe organizimi i ditëve të hapura

Gjatë vitit 2016 janë shpërndarë rreth 3300 kopje nga

- "Përmbledhje e Vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- Broshura informative mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në fushën e punësimit.
- Broshura informative mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e shërbimeve”.
- Broshura informative mbi ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në fushën e arsimit.
- “Përmbledhje e vendimeve të KMD-së dhe Opinioneve të Bordit të Ekspertëve”.
- Botimi me përkthime “Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Organeve të Barazisë”.
- Studim “Mbi problematikën e diskriminimit të komunitetit Rom në Shqipëri”.
- “Diskriminimi në arsim në këndvështrimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”.

Komisioneri ka realizuar 4 ditë të hapura me komunitetin.

II.3.2. Organizimi i trajnimeve, leksioneve dhe konferencave nga KMD

KMD ka organizuar 19 trajnime, 2 konferenca dhe ka marrë pjesë në rreth 30 seminare dhe aktivitete kombëtare dhe rajonale, nga të cilat përmendim:

➤ Trajnime të KMD në bashkëpunim me policinë

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit, gjatë periudhës Maj - Qershor 2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi trajnime mbi Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në të gjithë Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kanë zhvilluar 19 sesione trajnimi në 12 qarqe të Shqipërisë ku janë trajnuar në total 471 punonjës të Drejtorive Vendore të Policisë. Trajnimet janë fokusuar në prezantimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, rolin e institucionit të Komisionerit dhe trajtimin e rasteve të diskriminimit, duke sjellë si shembull standartet europiane mbi çështjet e diskriminimit, gjykuar nga Gjykata Europiane për të

Drejtat e Njeriut si dhe praktikat më të mira të KMD të çështjeve të shqyrtuara ndër vite, fusha e të cilave lidhej natyrisht me veprimtarinë e policisë. Lidhur me këto të fundit shfaqej dhe interesi më i madh dhe diskutimet ndërmjet përfaqësuesve të policisë dhe trajnuesve nga KMD, pa përjashtuar dhe diskutimet mbi kuptimin e diskriminimit, rastet më të përhapura për të cilat janë paraqitur më shumë ankesa, procedurat përpara KMD deri tek marrja e vendimit, çështjet e diskriminimit në gjykatë dhe vendimet gjyqësore lidhur me to, dallimet mes ankimeve përpara KMD dhe gjykatës, dëmshpërblimi për diskriminim etj.

Gjithashtu, gjatë trajnimeve të mbajtura në secilën Drejtori Vendore të Policisë, punonjësit e policisë referuan raste të evidentuara gjatë punës së tyre për t'i diskutuar me përfaqësuesit e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe kërkuan të njiheshin me raste specifike të cilat kishin lidhje me punën që ata kryenin çdo ditë.

Mbështetur në informacionet e administruara nga trajnimi i zhvilluar në Drejtoritë Vendore të Policisë, rezultoi se:

1. Punonjësit e Policisë kishin mungesë të theksuar informacioni mbi përmbajtjen e Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.
 2. Në disa prej Drejtorive Vendore të Policisë, përfaqësues të Seksionit të Trajnimeve kanë kërkuar vijimin e zhvillimit të trajnimeve mbi Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” edhe për punonjës të tjerë të këtyre drejtorive.
 3. Në asnjë nga Drejtoritë Vendore të Policisë nuk u evidentua publikimi i Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, në ambjentet e tyre në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 13 pika 2, ku parashikohet shprehimisht se “*Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara*”.
- Me datë 20.07.2016 KMD-së organizoi Takimin e dytë të Grupit ndër-institucional të Punës, në kuadër të projektit “*Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit*” financuar nga BE dhe implementuar nga KiE.
 - Komisioneri ka realizuar 6 leksione të hapura në Universitete.
 - 19 Dhjetor 2016. Komisioneri organizoi Konferencën me temë “Zbatimi i ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” me përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Delegacionit të BE-së, PNUD, institucioneve qendrore dhe vendore, OJF-ve.

II.4. Raportime, studime dhe monitorime

Gjatë vitit 2016, KMD ka hartuar raporte, informacione dhe kontribute, konkretisht:

➤ Raportime

- 30.03.2016 u zhvillua në Tiranë Takimi i 6-të i Dialogut të Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe, mes BE – Shqipëri.
- KMD ka dërguar informacion Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën 1 Janar - 31 Mars 2016.
- Takimin e Tetë të Nënkomitetit “*Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale*”, zhvilluar me datë 14 Prill 2016 në Bruksel;
- Raportim në Nënkomitetin për “*Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë*”, BE-Shqipëri, zhvilluar me datë 3 - 4 Mars 2016 në Tiranë;
- Raportim në kuadër të Konventës CEDAË në Sesionin 64 të Komitetit CEDAË, zhvilluar me datë 11 -12 Korrik 2016, në Gjenevë.
- Kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *Mbi takimin e shtatë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit*, mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas fushës që mbulon institucionin. Komisionerja ka raportuar në takimin e shtatë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, zhvilluar në Tiranë me datë 9 qershor 2016.
- KMD ka raportuar “*Mbi hartimin e kontributit të parë të Republikës së Shqipërisë për Raportin e Komisionit Europian 2016 për Shqipërinë për Kapitullin "Kriteri Politik" dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore"*, mbi zhvillimet kryesore për periudhën e raportimit, sipas fushës së veprimtarisë që mbulon.
- KMD ka raportuar “*Mbi hartimin e kontributit të dytë të Republikës së Shqipërisë për Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2016 për Kapitullin "Kriteri Politik" dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore"*, mbi zhvillimet kryesore për periudhën e raportimit, sipas fushës së veprimtarisë që mbulon.
- KMD ka hartuar informacion “*Mbi kontributin për plotësim informacioni për Komitetin Këshillues*”, bazuar në një pyetësor të këtij Komiteti.
- KMD ka hartuar Kontributin mbi Plotësimin e Pyetësorit e OHCHR-së⁵⁰.
- Kontributi i KMD-së në Maj 2016 mbi hartimin e raportit të ILO-s⁵¹.
- Në periudhën Maj 2016 KMD ka përgatitur materialin për Raportim në Zbatim të Konventës për “Punonjësit me Përgjegjësi Familjare.
- Raportim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi zbatimin e rekomandimeve të Konventës “*Kundër torturës, trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese*”

⁵⁰ Dërguar me shkresën nr. 1020/1 Prot., datë 25.11.2016

⁵¹ Dërguar me shkresën nr.500/1 Prot., datë 16.05.2016

- Raportim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të Konventës Kuadër “Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave”
 - Raportim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbështetur në rekomandimet e Komitetit Këshillues në kuadër të Konventës Kuadër “Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave”.
- KMD ka përgatitur një **“Studim Krahasimor mes legjislacionit shqiptar dhe atij europian “Mbi kriteret e pranimit të punonjësve të policisë”**.

Ky studim është hartuar me mbështetjen e anëtarëve të EQUINET - Rrjetit Europian të Organeve të Barazisë, ku edhe KMD është anëtar që në dhjetor 2014. KMD e ka vlerësuar anëtarësimin në EQUINET si një mundësi të mirë, veçanërisht në marrjen e eksperiencave më të mira nga vendet europiane të cilat kanë një praktikë më të konsoliduar në fushën e anti-diskriminimit. Lidhur me përgatitjen e këtij studimi, KMD ka bashkëpunuar me EQUINET në përcjelljen e informacionit të përmbledhur të dy çështjeve në hetim administrativ, me qëllim marrjen e eksperiencës së këtyre vendeve në zgjidhjen e rasteve të tilla dhe legjislacionit të brendshëm që parashikon këto zgjidhje.

KMD ka hartuar kërkesën drejtuar EQUINET duke e shpërndarë në të gjithë institucionet që janë anëtare në rrjetin europian të organeve të barazisë.⁵² Anëtarët e Equinet i janë përgjigjur kërkesës së KMD, duke kthyer përgjigje konkrete mbi pyetjet për rastet që po shqyrtohen nga KMD, praktikat e vendeve anëtare për rastet e shqyrtuara të diskriminimit në këtë fushë si dhe mbi parashikimet ligjore për rastet e pranimit në Shkollat e Policisë apo emërtimet sipas shteteve. Konkretisht, KMD ka marrë 10 përgjigje⁵³ nga vende të ndryshme europiane. Aktualisht ky studim është në fazën përfundimtare të hartimit

II. 5. Bashkëpunime

- **Pjesmarrja në grupe ndërinstitucionale.**
- Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”, përfaqësuesi i KMD-së, njëkohësisht anëtar i këtij GNP, ka marrë pjesë në të gjitha takimet periodike të zhvilluara pranë Ministrisë së Drejtësisë, për të diskutuar zhvillimet dhe për të vendosur për aktivitetet e ardhshme në kuadër të kapitullit “Kriteri Politik” dhe Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, për të cilat kjo ministri është institucion lider.
 - Me datë 2 nëntor 2016 u zhvillua tryeza konsultative mbi draft dokumentin **“Mbi standardet dhe parimet për punonjësit e administratës publike”**. Hartimi i këtij

⁵² Equinet është rrjeti i 45 organeve të Barazisë në 33 vende europiane që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave mbi legjislacionin e barazisë dhe politikave në nivel europian.

⁵³ Informacioni mbi përgjigjet e shteteve anëtare të EQUINET është vendosur bruto në këtë material, siç është dërguar në adresë të KMD, dhe është listuar sipas radhës së dërgimit.

dokumenti do të mundësohet në kuadër të projektit “Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Europian.⁵⁴

- Pjesëmarrje dhe kontribut i përfaqësuesit të KMD-së në takimet periodike të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 2&19, për të cilin institucion lider është Ministria e Mirqënies Sociale dhe Rinisë.
 - Pjesëmarrje si anëtare e MKV-së.
 - 24 Maj 2016. Pjesëmarrja në seancën dëgjimore në Kuvend, Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Planit Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në Internet.
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit “Mbi pakicat Kombëtare në Republikën e Shqipërisë” të drejtuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për Integrimin Evropian.
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare Për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit të punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit të punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020
 - Pjesëmarrje në takimet e Grupit të punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016 - 2020.
- Stafi i KMD është përfshirë në shtatë grupe pune të rrjetit EQUINET gjatë vitit 2016, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimin e praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Europës, konkretisht në:
1. Grupin e Punës për Legjislacionin e Barazisë
 2. Grupin e Punës për komunikimin, strategji dhe praktika
 3. Grupin e Punës për barazinë gjinore
 4. Grupin e Punës për hartimin e politikave
 5. Grupin e Punës për çështjet gjyqësore strategjike

⁵⁴ Support to Albanian Civil Service Reform ; The Twinning Project AL 12 IB OT 01 - funded by the European Union

6. Grupin e Punës për vlerësimin e projekteve
7. Grupin e Punës mbi standartet e Organeve të Barazisë

➤ **Marrëveshje Bashkëpunimi**

1. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Prot. 338, datë 18.03.2016.
2. Qendra Ndër fetare, Elbasan - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Prot. 995, datë 02.11.2016.
3. Bashkia Shkodër - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Prot. 1161, datë 28.12.2016.

➤ **Praktika Mësimore me Studentët**

Pranë zyrave të Komisionerit kanë zhvilluar praktikën mësimore 28 studentë të Masterit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe 2 studentë Fakulteti i Shkencave Sociale, dega Sociologji, Universiteti i Tiranës, 12 studentë nga Akademia Profesionale e Biznesit dhe Universiteti “ Marin Barleti”.

II.6. Projekte

Projektit i Përbashkët BE-KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”.

- Në kuadër të projektit të Përbashkët të BE dhe KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”, gjatë periudhës maj - tetor Komisionerja dhe stafi i KMD-së kanë zhvilluar takime me ekspertë ndërkombëtare të Këshillit të Europës, të cilët ofrojnë asistencë teknike në disa prej aktiviteteve në kuadër të këtij projekti. Qëllimi i këtyre vizitave ishte që konsulentët të mblidhnin informacionin e nevojshëm prej institucioneve partnere të projektit, përfshirë KMD, për të hartuar rekomandimet e tyre në lidhje me:
 1. Vlerësimin e Planit Strategjik 2011-2015, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me ekspertet përkatës.
 2. Hartimin e strategjisë së bashkëpunimit për Grupin ndër-Institucional të Punës
 3. Rishikimin/Përmirësimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe kuadrit ligjor që lidhet me zbatimin e këtij ligji.
 4. Përmirësimin e politikave të brendshme institucionale të KMD.
- Me datë 16.05.2016 dy përfaqësuesve të KMD-së morën pjesë në Takimin e parë të Grupit ndër-institucional të Punës, në kuadër të projektit “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit” financuar nga BE dhe implementuar nga KiE. Në takim merrnin pjesë edhe përfaqësues nga Avokati i Popullit

dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Gjatë këtij takimi, u diskutua mbi çështje të rëndësishme për vijimësinë e këtij projekti, nga ku citohet:

- Cilat janë nevojat e rritjes së kapaciteteve institucionale dhe si mund t'i adresojë këto nevoja projekti në fjalë (sesione trajnimesh specifike dhe përmirësimi i procedurave të brendshme/ procedurat e shqyrtimit të ankesës);
 - Sistemi i menaxhimit të çështjeve të KMD dhe 3 (tre) zyrat rajonale pilot të KMD;
 - Bashkëpunimi mes institucioneve partnere si dhe me institucionet kërkimore/universitetet
 - Zhvillimi i Planeve/strategjive të bashkëpunimit të Grupit ndër-institucional të punës;
 - Koordinimi mes KMD dhe Avokatit të Popullit, përbërja dhe mënyrat e funksionimit;
 - Vizitat studimore (vendndodhja dhe çështjet e interesit);
 - Tema të tjera të sugjeruara nga partneret përpara dhe gjatë takimit.
- Me datë 20.07.2016 stafi i KMD-së mori pjesë në Takimin e dytë të Grupit ndër-institucional të Punës, në kuadër të projektit “*Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit*” financuar nga BE dhe implementuar nga KiE. Komisionerja moderoi mbledhjen, ku merrnin pjesë edhe katër përfaqësues të tjerë nga KMD, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Europës dhe ekspertë ligjorë. Gjatë këtij takimi u diskutuan: çështjet e diskriminimit dhe format e tij; sfidat dhe përvojat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit; u paraqitën ndryshimet në Ligjin për Mbrojtjen kundër Diskriminimit si dhe u diskutua hapja e tre zyrave rajonale në Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë.
 - Në datat 22 - 24 nëntor 2016, pjesëmarrje në Workshopin 3-ditor me qëllim prezantimin dhe diskutimin e gjetjeve të Raporteve të misioneve të vlerësimit me institucionet përfituese të projektit.

KAPITULLI III

ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

III.1. Menaxhimi i burimeve njerëzore

- Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2016, u zhvillua *kursi mbi Anti-diskriminimin të Platformës HELP të Këshillit të Europës (KiE-së)*, mundësuar në kuadër të Projektit “*Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit*”, financuar nga Bashkimi Europian dhe Këshilli i Europës dhe implementuar nga Këshilli i Europës. Ky kurs, në të cilin morën pjesë 14 punonjës nga stafi i KMD-së, u zhvillua me 5 (pesë) module, konkretisht:

Moduli 1: Neni 14 i KEDNJ-së për ndalimin e diskriminimit

Moduli 2: Diskriminimi kundër Romëve

Moduli 3: Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe gjinor dhe KEDNJ-së

Moduli 4: Diskriminimi për shkak të Aftësisë së Kufizuar

Moduli 5: Diskriminimi për shkak të racës, etnisë dhe origjinës kombëtare

- Gjithashtu, me datë 2 dhjetor 2016 u zhvillua moduli/trajnimi face to face me temë “Diskriminimi për shkak të gjinisë”.
- Me datë 21-22 shtator 2016 u zhvillua trajnimi me temë “*Institute të së drejtës procedurale administrative sipas Kodit të Ri të Procedurave Administrative*”, i organizuar në kuadër të projektit “*Mbështetje për Reformën e Shërbimit Civil në Shqipëri*”, financuar nga Bashkimi Europian. Në këtë trajnim merrnin pjesë 12 përfaqësues të KMD si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore. Temat e trajnimit ishin: Akti administrativ - ligjshmëria dhe paligjshmëria; Procedimi Administrativ - risi të procedimit/pjesëmarrja në procedimin administrativ; Përfundimi i procedimit administrativ; heshtja administrative; ndërthurja me procesin gjyqësor; premisat ligjore dhe gjyqësore; Mjetet ligjore të mbrojtjes në procedimin administrativ – apelimi administrativ.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2016, punonjësit e KMD, kanë marrë pjesë në aktivitetet e Equinet si: seminare kualifikuese dhe konferenca me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve europiane të barazisë dhe shkëmbimin e eksperiencave, ku përmendim:
 - Seminarin “*Aksesueshmëria dhe Përshtatja e Arsyeshme*”, organizuar nga Equinet dhe Ombudsmeni Austriak për Aftësinë e Kufizuar, zhvilluar në datat 4 - 5 Prill 2016, në Vienë, Austri. Seminari synonte mbledhjen e eksperiencave të organeve të barazisë mbi aksesueshmërinë dhe përshtatjen e arsyeshme. Gjithashtu seminari synonte ngritjen e kapaciteteve në të kuptuarit, promovimin dhe sigurimin e aksesueshmërisë dhe përshtatjes së arsyeshme.

- Seminarin “*Barazia Gjinore në Arsim*”, organizuar nga Equinet dhe Mbrojtësi Publik i të Drejtave i Republikës Çeke, zhvilluar në datat 19 - 20 Maj 2016, në Pragë, Republika Çeke. Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte forcimi i kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të organeve të barazisë gjinore rreth temës kryesore që lidhet me edukimin gjinor në shkolla.
- Seminarin me temë “*Lufta ndaj Diskriminimit për shkak të Racës dhe Përkatësisë Etnike*”, organizuar nga EQUINET në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Hungari, zhvilluar në datat 08-10 nëntor 2016, në Budapest, Hungari.
- Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (AGM) të Equinet, me pjesëmarrjen e të gjithë përfaqësuesve të Institucioneve Europiane të Barazisë që janë anëtare të rrjetit, organizuar nga Equinet, në datat 29 - 30 Shtator 2016 në Bruksel, Belgjikë.
- Konferencën me temë “*Diverse, Inclusive and Equal: Innovating at the intersections of gender equality*”, zhvilluar me datë 7 dhjetor 2016, në Bruksel, Belgjikë. Aktiviteti u zhvillua në Bruksel, me pjesëmarrjen e vendeve anëtare të kësaj organizate dhe të ftuar special profesorë të Universiteteve Amerikane.

III.2. Menaxhimi i burimeve financiare

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit “Për Buxhetin e vitit 2016”, në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”,

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjeve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në zbatim të ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2016, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej 38.000 (në mijë lekë) për vitin 2016. Totali i vlerës së akorduar duke përfshirë edhe fondin e donatorëve prej 147,68 (në mijë lekë) përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	22. 200	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4. 800	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	10. 000	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>
Fondi për Investime:	1. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>
Fondi i Donacioneve:	147, 68	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>

Nga fondi i planifikuar vjetor prej 38.000 (në mijë lekë), për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore 26.466,99 në mijë lekë ose 69,65 % e buxhetit total mujor të akorduar. Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, numri mesatar i punonjësve është realizuar 21 vetë, nga 23 vetë të miratuar. Nga fondi i përgjithshëm i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej 22.200 (në mijë lekë) për këtë periudh, është realizuar respektivisht; 18.011,79 (në mijë lekë) për paga nga zëri 600 si dhe 2.807,46 (në mijë lekë) për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore nga zëri 601 ose 93,78 % e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë. Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej 1.000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar nuk është arritur të realizohet gjatë vitit. Në zërin investime, projektet janë:

1. “Rikonstrukcion zyrash” me vlerë 100 (në mijë lekë)
2. “Blerje pajisje zyrash” me vlerë 120 (në mijë lekë)
3. “Blerje pajisje kompjuterike” me vlerë 780 (në mijë lekë).

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602); për vitin 2016, është planifikuar në vlerën 10,000 në mijë lekë. Për periudhën respektive është planifikuar vlera prej 10.000 (në mijë lekë) dhe është realizuar vlera prej 5.407,74 (në mijë lekë) ose

54.08 %, e fondit të vitit të palnifikuar. Fondi i Donacioneve (zëri 602); për vitin 2016, është në vlerën 147,68 (në mijë lekë). Për periudhën respektive nuk është realizuar asnjë vlerë, sepse marrëveshja ka përfunduar dhe vlera e mësipërme do ti kthehet U.N.D.P.-së. Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi dhe realizimi ka qënë në masën 69,65 % .